



PEACE CORPS KOSOVO

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrenia "UKSHIN HOTI"	
Prantuar më datë: 13-04, 2022	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-147

Data:

Universiteti "Ukshin Hoti"

Prizren

Prof. Asoc.Dr. Samedin Krrabaj,

Rektor

Tel: 029 232-140

e-mail: rektorati@uni-prizren.com

I nderuar Prof. Asoc.Dr. Krrabaj,

Kjo letër shërben për të dokumentuar qëllimet dhe mirëkuptimin reciprok të Korpusit të Paqes, që operon përmes zyrës së saj në Kosovë dhe Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në lidhje me ndihmën e kërkuar nga partneri vendor në lidhje me Programin Pilot Virtual të Korpusit të Paqes (VSP) ashtu siç ceket më hollësisht në Deklaratën (bashkangjitur) e Angazhimit Virtual (SOVE).

Siç e dini, Korpusi i Paqes evakoi të gjithë Vullnetarët e Korpusit të Paqes (PCV) nga vendet e tyre të shërbimit në Mars 2020. Ndërsa ne vazhdojmë të punojmë për kthimin e Vullnetareve në terren, Korpusi i Paqes ka shqyrtuar mënyra për të vazhduar angazhimin dhe ndihmën për partnerët tanë nga vendet nikoqire. Pas diskutimeve gjatë disa javëve të fundit midis stafit të vendeve që kanë bashkëpunim me Korpusin e Paqes dhe stafit tuaj, ne jemi të lumtur që do të jemi në gjendje për të ofruar ndihmë për universitetin përmes Programit Pilot të Shërbimit Virtual të Korpusit të Paqes (VSP). Kjo mundësi e re bashkëpunimi dallohet nga shërbimi i vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Shërbimit të Reagimit të Korpusit të Paqes për të cilët mund të keni njohuri. Përmes programit virtual (VSP), ish-vullnetarët e Korpusit të Paqes do të dhurojnë kohën e tyre dhe shërbimet vullnetare për t'u angazhuar virtualisht me partnerët tanë të vendit pritës, siç është Universiteti "Ukshin Hoti", për të përfunduar aktivitetet, projektet dhe detyrat e zhvilluara në bashkëpunim midis stafit tuaj dhe stafit të Korpusit të Paqes. Këto aktivitete, projekte dhe detyra janë të detajuara në dokumentin e bashkangjitur si Deklaratë e Angazhimit Virtual (SoVE) e cila i është bashkangjitur kësaj letre. Individët që dhurojnë kohën e tyre dhe shërbimet vullnetare do të identifikohen si Pjesëmarrës të VSP. Ato nuk kompensohen (përveç një shume të vetme të caktuar për të rimbursuar lidhjen në internet, ngjyrë për printer dhe letër, si dhe shpenzime të ngjashme) që ofrohet nga Korpusi i Paqes dhe nuk parashihet që ata të kenë ndonjë përfitim të cilin organizata ua akordon vullnetareve ose punonjësve të saj. Angazhimi i pjesëmarrësve të programit VSP do të jetë ekskluzivisht virtual me një bashkëpunëtor vendor të vendit nikoqir i cili është caktuar nga ekipi juaj, në koordinim, konsultim si dhe sipas udhëzimeve të stafit të Korpusit të Paqes.



PEACE CORPS KOSOVO

Stafi i Korpusit të Paqes është i ngazëlyer për mundësinë për të punuar me ekipin tuaj. Në mënyrë që angazhimi i VSP të jetë efektiv dhe produktiv, është e rëndësishme të përcaktohen pritjet, synimet dhe mirëkuptimet si më poshtë në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e Korpusit të Paqes dhe universitetit tuaj, si partneri ynë vendor.

I. Rolet dhe Përgjegjësitë e Korpusit të Paqes dhe Korpusit të Paqes në Kosovë

Korpusi i Paqes dhe Korpusi i Paqes në Kosovë synojnë si në vijim:

- Të punojë me partnerin vendor për të zhvilluar një Deklaratë të Angazhimit Virtual (SoVE) dhe të përshkruaj qartë aktivitetet, projektet ose detyrat për pjesëmarrësin në program.
- Të përzgjedhë, mbështes dhe udhëzojë pjesëmarrësin në program VSP me kualifikimet dhe aftësitë e duhura.
- Të ofrojë trajnim orientues në Programin VSP dhe në lidhje me punën e Pjesëmarrësit të VSP me partnerin vendor dhe bashkëpunëtorin vendor. Ta prezantojë partnerin vendor dhe bashkëpunëtorin me Pjesëmarrësin e programit të VSP-së.
- Të mbështesë aktivitetet, projektet dhe detyrat e detajuara në Deklaratën e bashkangjitur të Angazhimit Virtual (SOVE) përmes angazhimit të Pjesëmarrësit të VSP.
- Të ofrojë një anëtar stafi të Korpusit të Paqes Kosovë i cili do të koordinojë dhe konsultohet me Partnerin vendor, Bashkëpunëtorin vendor dhe Pjesëmarrësin e VSP-së, dhe të sigurojë ndihmë dhe mbështetje adekuate sipas nevojës gjatë periudhës së angazhimit në program SoVE, përfshirë adresimin e çdo çështjeje ose shqetësimit që mund të lindin gjatë angazhimit.

Për shkak që Programi Virtual (VSP) varet plotësisht nga dhurimi i kohës dhe shërbimeve vullnetare të Pjesëmarrësit në VSP, ndihma e ofruar nga Pjesëmarrësi VSP për t'u përfshirë në aktivitetet, projektet dhe detyrat e SoVE mund të përfundojë nëse Pjesëmarrësi i VSP zgjedh të përfundojë pjesëmarrjen e tyre, ose Korpusi i Paqes zgjedh të ndërpresë angazhimin e Pjesëmarrësit në VSP për ndonjë arsye.

II Rolet dhe Përgjegjësitë e Partnerit të Vendit Nikoqir

Partneri i vendit nikoqir synon të:

- Angazhohet në një frymë bashkëpunimi, mësimi të ndërsjellë dhe respekti me Pjesëmarrësin në VSP, në koordinim dhe konsultim me personelin e Korpusit të Paqes Kosovë, vetëm për aktivitetet, projektet dhe detyrat e përcaktuara në Deklaratë të Angazhimit Virtual (SOVE) të bashkangjitur, të cilat partneri vendor i konfirmon si të sakta dhe të pranuar nga partneri vendor. Partnerët vendor dhe stafi i Korpusit të Paqes Kosovë mund të koordinojnë dhe rishikojnë çdo aktivitet, projekt ose detyrë, sipas rastit, të dokumentojnë ri-shikimet e tilla me shkrim, dhe në përputhje me rrethanat të informojnë Pjesëmarrësin në VSP për ndryshime të tilla.
- Caktojë një Bashkëpunëtor vendor i cili është i disponueshëm dhe i gatshëm të angazhohet vazhdimisht me Pjesëmarrësin e programit VSP dhe stafin e Korpusit të Paqes Kosovë gjatë gjithë periudhës së angazhimit, duke përfshirë identifikimin e orareve të përbashkëta dhe të përshtatshme për zonën kohore për të komunikuar dhe punuar rregullisht me Pjesëmarrësin e VSP; bashkëpunëtori vendor dhe partneri vendor duhet t'i japin sugjerime në të gjitha



PEACE CORPS KOSOVO

aspektet e angazhimit stafit të Korpusit të Paqes Kosovë me qëllim të vlerësimit, përmirësimit dhe ngritjes së kualitetit të programit VSP.

- Angazhohet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese, qoftë drejtpërdrejt ose përmes bashkëpunëtorit vendor, me Pjesëmarrësin në VSP virtualisht dhe siç detajohet në SoVE; e kuptojnë që pjesëmarrësit e VSP nuk janë vullnetarë të Korpusit të Paqes dhe se angazhimi i tyre është i kufizuar në 5-15 orë kohë të dhuruar në javë, ndërsa ata mbajnë angazhimet e tyre personale të tilla si puna ose studimi akademik.
- Respektojë termet dhe kushtet e Deklaratës SoVE, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, orët dhe oraret e punës, ose aktivitete të tjera jashtë atyre të detajuara në SoVE, të tilla si kufizimet mbi Pjesëmarrësin VPS që bën ndonjë mbledhje fondesh ose aktivitete të ngjashme për Partnerin vendor, bashkëpunëtorin vendor, ose ndonjë entitet, grup ose individ të lidhur me Partnerin vendor ose bashkëpunëtorin vendor.
- Kuptojë dhe informojë bashkëpunëtorin vendor se të gjithë individët që përfshihen në aktivitetet dhe detyrat e detajuara në SoVE (përfshirë partnerin vendor, bashkëpunëtorin vendor, stafi i Korpusit të Paqes Kosovë si dhe Pjesëmarrësi i VSP) pritet që dhe duhet të komunikojnë dhe të sillen vetë në një mënyrë të përshtatshme, pa u përfshirë në ndonjë lloj të ngacmimit në internet, ose shkëmbimit të mesazheve ose imazheve që mund të konsiderohen diskriminuese, ngacmuese, kërcënuese, frikësuese, ofenduese, seksuale ose të përfshihen në sjellje të tjera seksuale ose takime në internet, ose që janë inkurajuese të sjelljes së njëjtë ose të ngjashme.
- Kuptojë dhe informojë bashkëpunëtorin vendor dhe Pjesëmarrësit e VSP-së nuk duhet: të takojnë ose të bëjnë telefonata ose të dërgojnë mesazhe tek të miturit (nën moshën 18 vjeç) pa praninë, përfshirjen ose pjesëmarrjen e personelit vendor ose personelit të Korpusit të Paqes Kosove, të marrin ose të ndajnë imazhet e të miturve që janë pjesë e aktiviteteve ose detyrave të sipas Deklaratës së Angazhimit Virtual (SoVE), përveç nëse kanë marrë leje të nënshkruara nga prindërit (formulari i bashkangjitur) ose që t'u kërkohet ose lejohet të përfshihen në ndonjë aktivitet tjetër që mund të shkelë politikën e Korpusit të Paqes në lidhje me Mbrojtjen e Fëmijëve, një kopje e së ciles i ofrohet Partnerit vendor.
- Njoftojë stafin e Korpusit të Paqes Kosove në rast se partneri vendor ka njohuri ose informohet për ndonjë sjellje ose angazhim të papërshtatshëm nga Pjesëmarrësi i VSP-së ose bashkëpunëtori vendor dhe të adresojë në kohë çdo çështje të ngjashme me bashkëpunëtorin vendor. Partneri vendor e kupton që stafi i Korpusit të Paqes Kosove është në dispozicion për të ndihmuar dhe adresuar çdo çështje ose shqetësim që mund të lindë gjatë angazhimit.

Për shkak se ky Shërbim Virtual (VSP) varet plotësisht nga dhurimi i kohës dhe shërbimeve vullnetare të Pjesëmarrësit në programin VSP, partneri vendor kupton dhe pranon që programi VSP mund të përfundojë në çdo kohë nëse Pjesëmarrësi i VSP zgjedh të përfundojë angazhimin e tyre, ose nëse Korpusi i Paqes zgjedh të ndërpresë angazhimin e Pjesëmarrësit të VSP-së për ndonjë arsye dhe se Korpusi i Paqes nuk ka asnjë detyrim të sigurojë një Pjesëmarrës tjetër të VSP-së.

Stafi i Korpusit të Paqes pret që të angazhohet me partnerin vendor të Programit Virtual (VSP) në aktivitetet, projektet dhe detyrat e Deklaratës së Angazhimit Virtual (SoVE). Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni, Edita Kiseri Alo, menaxheren e programit në Korpus të Paqes.

Korpusi i Paqes dhe Partneri i vendit nikoqir synojnë që versioni në gjuhën angleze i kësaj letre të kontrollohet.



PEACE CORPS KOSOVO

Nëse dispozitat e paraqitura në këtë letër dhe në Deklaratën e Angazhimit Virtual (bashkangjitur) janë në përputhje me pritjet, mirëkuptimin dhe synimet e Partnerit vendor në lidhje me angazhimin në Programin Pilot të Shërbimit Virtual të Korpusit të Paqes, ju lutemi nënshkruani më poshtë për ta deshmuar këtë.

Sinqerisht,

PRANUAR DHE PAJTUAR NGA:

Dr. Carolyne Siganda,
Krrabaj

Drejtoreshë e Zyres Korpusi i Paqes Kosove

Nënshkrimi

Data: 12.04/2022

Prof. Asoc.Dr. Samedin

Rektor i Universitetit "Ukshin Hoti"
Prizren

Nënshkrimi

Data: 12.04.2022



PEACE CORPS KOSOVO

Bashkangjitur

Deklarata e Angazhimit Virtual

PROGRAMI PILOT I SHERBIMIT VIRTUAL

INFORMACION I PERGJITHSHEM:

Pershkrimi i sherbimit virtual:	Bashke-dizajnimi dhe ofrimi i kursit te Bazave te Analizes Kuantitative Te Te Dhenave
Numri I references:	
Shteti:	Kosove
Numri i pjesemarrreseve (VSPP) te kerkuar:	1
Vlen per:	<input type="checkbox"/> RPCVs <input checked="" type="checkbox"/> TË GJITHA RPCV-TË (ÇDO RPCV NGA ÇDO VEND)
Data e Fillimit:	Data e fillimit te angazhimit : Me/ose rreth dates 5 prill 2022
Data e Perfundimit:	Data e perfundimit te angazhimit: Me/ose rreth dates 20 qershor 2022
Kohezgjatja:	Deri 12 jave, duke perfshire edhe tranimin orientues
Spektori:	Arsimi I larte

KERKESAT PER MBIKEQYRJE:

Pjesemarrresi i programit pilot te sherbimit virtual (ang: VSPP) i raporton Drejtorit te Programit dhe Trajnimeve te Korpusit të Paqes (DPT) dhe menaxherit të programit TEFL. Pjesemarrresi i programit virtual I permbahet Marreveshjes se Programit Pilot dhe Donacionit si dhe Parimeve te Angazhimit të Pjesëmarrësve. VSPP-ja do të mbetet ne kontakt me partnerin e caktuar të vendit nikoqir në baza javore ashtu siç do të diskutohet gjatë orientimit me bashkepunetorin e vendit nikoqir.



PEACE CORPS KOSOVO

Emri dhe titulli i stafit: Edita Alo, Menaxhere e Programit TEFL dhe/ose Brenda Dean, Drejtoreshë e Programit dhe Trajnimit

Emri dhe titulli i homologut: Sermin Turtulla, Ass. Prof Dr.

HISTORIKU I PARTNERIT TE PROGRAMIT:

Partneri i vendit nikoqir:	Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit Institucioni arsimor publik i vendit nikoqir
Tipi i organizates:	Government
Misioni dhe Qellimet e Partnerit te Shtetit Nikoqir:	Ministria e Arsimit dhe Shkencës i jep prioritet kërkimit dhe inovacionit si pjesë e strategjisë së saj të përgjithshme zhvillimore dhe përpjekjeve për rritjen e cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e cilësisë së kërkimit në Kosovë.
Emri dhe titulli i bahkepunëtorit te VSSP te Shtetit Nikoqir:	Prof. Ass. Dr. Sermin Turtulla

AKTIVITETET/ TE DHENA MBI PROJEKTIN: (1-2 PARAGRAFE)

Ky projekt synon të ofrojë një hyrje në bazat e të dhënave kuantitative (sasiore) dhe përdorimin e metodave sasiore në hulumtimet e studentët të universitetit. Ky kurs do të fokusohet në njohjen e studentëve me filozofinë dhe aplikimin e arsimit statistikor dhe metodave të analizës statistikore për analizën e provave të të dhënave sasiore. Gjate këtij projekti do të eksplorohehen dhe zhvillohen aftësitë kryesore praktike që përfshijnë rolin dhe qëllimin e statistikave si një mjet analitik brenda një projekti kërkimor. Theksi do të vendoset në arritjen e një kuptimi të metodave sasiore dhe teknikave statistikore shoqëruese në fjale në mënyrë që studentët të mund të mendojnë në mënyrë kritike për procedurat e përshtatshme për hartimin e kërkimit, mbledhjen, analizën e të dhënave dhe dobën e statistikave. Universiteti "Ukshin Hoti" nuk ka punuar më parë me vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyer për Korpusin e Paqes në Kosovë që të krijojë një partneritet të ri në nivel universitar.

Pjesëmarrësi i programit të shërbimit virtual (VSP) do t'i ndihmojë studentët të mësojnë t'i kthejnë numrat e papërpunuar në të dhëna kuptimplotë përmes aplikimit të menduarit racional dhe kritik për t'u zbatuar në problemet dhe punën e botës reale. Universiteti nuk ka SPSS ose softuer tjetër të



PEACE CORPS KOSOVO

përdorur zakonisht, prandaj, pjesëmarrësi (VSP) do të ndihmojë në identifikimin e softuerit të disponueshëm ose pa pagese që mund të sigurojë analiza të përbashkëta analitike sasiore që studentët mund të përdorin gjatë kursit për të praktikuar dhe mund ta kenë në dispozicion më tej gjatë studimeve të tyre.

ANGAZHIMI DHE DETYRAT E SHËRBIMIT VIRTUAL:

Pjesëmarrësi Pilot i Shërbimit Virtual (VSPP) do të punojë në partneritet të ngushtë me homologun e tij në Universitetin e Prizrenit për t'u angazhuar në detyrat e mëposhtme:

- Te angazhohet në diskutim, hartoni dhe bini dakord mbi planin e punës dhe për të bashkë-krijuar aktivitetet fillestare me homologun, VSPP dhe TEFL PM.
- Te bashkë-zhilloje përmbajtjen e kursit dhe te dakordohet për metodat e ofrimit të kursit. Pjesëmarrësit e kursit do të përzgjidhen nga homologu nga grupi i studentëve që studiojnë në vitin e tyre të fundit.
- Te bashkë-krijoje dhe diskutoje përbërjen e kursit dhe finalizimin e procesit, (takim me homologun dy herë në javë për një orë për dy javët e para dhe takime bashkerenduese individuale të mëpasshme me homologun, çdo javë më pas).
- Te bashkë-zhilloje materialet dhe përmbajtjen e kursit.
- Te bashke-ofroje ore mesimore mbi analizën sasiore për të avancuar aftësitë kërkimore të studentëve.
- Te ofroj sugjerime (feedback), rishikoj detyrat dhe vlerësimin sipas nevojës.

Deri në fund të Shërbimit Virtual:

- Së paku 10 studentë do të fitojnë njohuri për konceptet dhe analizat themelore statistikore në metodologjinë sasiore.
- Të paktën 10 studentë do të jenë në gjendje të përgatisin anketa, të përgatisin analiza dhe të bëjnë analiza të të dhënave në softuer të identifikuar duke përdorur teknika të zakonshme analitike.
- Të paktën 10 studentë do të jenë në gjendje të bëjnë projekte kërkimore, të cilat përfshijnë përdorimin e metodave sasiore, të shkruajnë në mënyrë shkencore rreth projektit dhe të interpretojnë rezultatet.

Ky angazhim pritet të zgjasë afërsisht 12 javë. VSPP-të pritet të angazhohen në detyrat e cekura më sipër për rreth 5-15 orë në javë.

- Takimet ndërmjet VSPP-ve dhe homologëve të vendit pritës do të zhvillohen gjatë pasditeve të orarit normal të punës, nga ora 15:00-18:00. Kohët specifike do të përcaktohen gjatë orientimit.



PEACE CORPS KOSOVO

- Mësimet do të zhvillohen nga ora 15:00 deri në 18:00 me orën lokale.
- Kosova është +6 orë përpara zonës kohore EST.
- Vendi pritës Counterpart do të ketë akses në internet, laptop dhe platforma të ndryshme (zoom, google meet etj.) për komunikim dhe bashkëpunim të rregullt.
- Sipas Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve, kur angazhoheni në internet me të mitur (0-18), duhet të jenë të pranishëm dy persona të rritur.

KUALIFIKIMET ESENCIALE:

Arsimi: Diplomë Bachelor i Arteve/Bachelor i shkencave në çdo disiplinë.

Aftësitë teknike:

- Aftësitë e analizës statistikore.

Përvoja:

- Përvojë në aplikimin e metodave kërkimore, analizave statistikore dhe aplikimeve të softuerit analitik.
- Të ketë përvojë në mësimdhënie në shkolla të mesme, studentë të universitetit ose nxënës të rritur.

Aftësitë dhe motivimi ndërkulturor: fleksibilitet, shkathtësi e fortë ndërkulturore, tolerancë e lartë ndaj paqartësive, i/e aftë për të punuar në mënyrë të pavarur, i/e shkathët, krijues/e dhe i/e motivuar dhe i/e aftë për të shërbyer virtualisht

KUALIFIKIMET E PREFERUARA:

Aftësitë teknike:

- Njohuri rreth angazhimit dhe komunikimit virtual.
- Aftësi në teknologji informative (IT) për të krijuar ose qasur në aktivitete të përshtatshme në internet, mjete ndihmëse vizuale dhe aftësi për të përdorur softuer të disponueshëm ose pa pagese që mund të ofrojnë analiza të zakonshme analitike sasiore.



PEACE CORPS KOSOVO

Përvoja:

- Përvojë në zhvillimin dhe hartimin e planeve mësimore.
- Përvojë në punë kërkimore sasiore ose statistikore.
- Përvojë jetese në vendet e Ballkanit.
- Përvoja e mësimdhënies së metodave të kërkimit për studentët e universitetit.
- Përvojë me vizualizimin e të dhënave.

AKTIVITETE SHITESE OPSIONALE:

Misioni i Korpusit të Paqes është të promovojë paqen dhe miqësinë botërore duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë njerëzit e vendeve të interesuara në plotësimin e nevojave të tyre për burra dhe gra të aftësuar.
2. Për të ndihmuar në promovimin e njohjes më të mirë të amerikanëve nga ana e popujve ku vullnetaret shërbejnë.
3. Për të ndihmuar në promovimin e njohjes më të mirë të popujve të tjerë nga ana e amerikanëve.

Qëllimi 1 do të arrihet nëpërmjet angazhimit të VSPP-së dhe përfundimit të detyrave të mësipërme. Homologu dhe VSPP mund të zgjedhin gjithashtu të identifikojnë një aktivitet që përputhet me Objektivin 2. Për më tepër, VSPP mund të identifikojë një aktivitet të Objektivit 3 për ta zbatuar gjatë angazhimit të tyre. Këtu përshkruhen një sërë rekomandimesh dhe mjetesesh për aktivitetet e Objektivit 3.

TERMET DHE KUSHTET E ANGAZHIMIT:

VSPP-të do të angazhohen në distancë nga SHBA me partnerin e vendit pritës, në koordinim me stafin e Korpusit të Paqes. Ata duhet të kenë akses në kompjuter, internet dhe telefon në mënyrë që të mundësojnë angazhimin e drejtpërdrejtë me zyrën e Korpusit të Paqes dhe homologun e vendit pritës të caktuar nga partneri i vendit pritës.

Trajnimi orientues me partnerin e vendit pritës do të ofrohet, brenda orëve të caktuara të shërbimit virtual, gjatë javës së parë të shërbimit virtual nëpërmjet një prezantimi dhe diskutimi në internet. Partneri i vendit pritës do të ofrojë një pasqyrë të organizimit të tij, kontekstit lokal dhe se si ata parashikojnë bashkëpunimin me VSPP.

VSPP do të mbajnë takime të rregullta me homologun e tyre dhe mbledhje dy-javore me stafin e Korpusit të Paqes. Diskutimet gjate kohes se lire (te pastrukturuar) me homologët mund të jenë me rëndësi kritike për ndërtimin e marrëdhënieve dhe kjo inkurajohet përmes aktiviteteve të tilla si bisedat virtuale gjate kohes se pauzes per kafe dhe telefonatat joformale brenda 10 orëve javore.



PEACE CORPS KOSOVO

ANGAZHIMET DHE SPECIFIKAT E SIGURISE:

Pjesemarreseve te programit (VSPP) do tu ofrohet një trajnim orientues mbi Politikat eKorpusit të Paqes mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe mënyrën se si keto politika nderlidhen me angazhimin në internet së bashku me praktikat më të mira të sigurisë së IT. Nga pjesemarresit (VSPP) pritet të ndjekin udhëzimet e sigurisë për angazhimin në internet për të garantuar sigurinë e tyre dhe të partnerit të vendit pritës dhe homologut të tyre, si dhe të çdo përfituesi të angazhimit.